

**BEQIR META**

**RAPORTET E NATO-s ME SHQIPËRINË  
GJATË LUFTËS SË FTOHTË\***

NATO u krijua në momentet e para dhe dramatike të fillimit të Luftës së Ftohtë si një instrument politiko-ushtarak i bashkimit të demokracive në betejën për të mbrojtur vetveten dhe njerëzimin nga rreziku i ekspansionit komunist. Shqipëria në këtë kohë u ndodh në anën tjetër të barikadës dhe është e kuptueshme që marrëdhëniet e saj me NATO-n ishin armiqësore. Por pikërisht në këtë pejsazh të errët është shumë e rëndësishme të shohim të gjithë elementet e këtyre marrëdhënieve për të kuptuar shumë procese të atëherëshme por edhe të sotme historike.

Në këtë kuadër është me shumë interes të analizojmë qëndrimet, politikat dhe konceptet e NATO-s dhe të shteteve anëtare të saj kundrejt pavarësisë dhe tërësisë territoriale të shtetit shqiptar.

Në momentet e fundit të luftës civile greke, të cilat përkojnë me fillimet e NATO-s u kërkua nga qeveria greke kryerja e një sulmi kundër Shqipërisë e cila ishte shndërruar një mbeshtetëse e rëndësishme për rebelët komunistë grekë. Por dy fuqitë kryesore të NATO-s në këtë kohë SHBA dhe Britania e Madhe e hodhën poshtë kërkesën e qeverisë greke për të sulmuar ushtarakisht dhe për të pushtuar Shqipërinë. Ata nuk kishin se si t'i pëlqenin këto propozime të grekëve, në një kohë kur po merrnin masa kundër kërcënimit të paqes në Ballkan dhe po përpiqeshin për ta kanalizuar situatën e atjeshme në mënyrë të tillë, që të mos dëmtonte interesat e aleateve perendimore. Duke punuar bashkë me britanikët në këtë çështje, amerikanët po nxisnin qeveritë greke dhe jugosllave që të shmangnin me vendosmëri ndonjë ndërhyrje ushtarake në Shqipëri, e cila mund të provokonte ndonjë sulm të Kominternit kundër Jugosllavisë.

Fuqitë Perëndimore, ndonëse ishin të pakënaqura me situatën në Shqipëri, ishin të shqetësuara jo vetëm nga reagimet e mundshme të sovjetikëve, por gjithashtu edhe për pasojat që do të kishte invazioni grek në qëndrimet e Beogradit kundrejt Greqisë dhe Perëndimit.

---

\* Kumesë e mbajtur në Konferencën Shkencore "Shqipëria dhe NATO", organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë, 16 qershor 2008.

Ne vijim erdhi gjithnje duke u afirmuar qëndrimi i mëparshëm i ShBA, e cila ishte fuqia drejtuese e NATO-s se qëllimi i largët ishte krijimi i një Shqipërie të lirë nga ndikimi i huaj dhe që qeveria e saj të ishte përgjegjëse kundrejt vullnetit të popullit shqiptar. Megjithatë atëhere kishte pikëpamje se asnjë regjim shqiptar nuk mund të ishte i lirë prej ndikimit të huaj ose i pavarur prej ndihmës së jashtme për shkak të dobësisë së brendshme që ekzistonte në vend dhe se për më tepër, në të ardhmen, për një farë kohe, institucionet përfaqësuese në Shqipëri mund të ekzistonin vetëm në një formë fillestare. SHBA kishin shprehur interesin e vendosur që në Shqipëri të mos lejohej ndikimi i huaj, i cili mund të merrte formën e dominimit. Ky ndikim duhej të drejtohej në mënyrë të tillë, që shqiptarët të ndihmoheshin për të qeverisur e mbrojtur vetveten. Nëpërmjet zhvillimeve të tilla, ShBA shpresonin në krijimin e marrëdhënieve të mira midis Shqipërisë, Greqisë, Jugosllavisë dhe Italisë dhe në orientimin e Shqipërisë drejt Perëndimit.

Ndërsa qëllimet e afërta të NATO-s ishin: dobësimi dhe eliminimi përfundimtar i dominimit sovjetik në Shqipëri që realizohej përmes regjimit të E. Hoxhës; ndalimi i përdorimit të mëtejshëm të Shqipërisë si bazë për veprimet e guerriljeve kundër Greqisë dhe sidomos kundër Jugosllavisë; nxitja e afrimit midis Beogradit dhe Athinës dhe midis Beogradit dhe Romës; mohimi i të drejtave të vendosjes së bazave ushtarake sovjetike në Shqipëri në kohë paqeje.

Fuqitë kryesore të NATO-s në këtë kohë vendosën që, për të arritur objektivat e veta në Shqipëri, duhej të vepronin në mënyrë tepër elastike. Ata përkrahnin rekomandimin për përdorimin e ndikimit të ShBA, Britanisë së Madhe dhe të Francës, që të ndalohej pjesëmarrja e regjimit të E. Hoxhës në organizmat ndërkombëtarë. Nga ana tjetër anëtarët e NATO-s përpiqeshin të shfrytëzonin çdo forcë antikomuniste për rrëzimin e qeverisë së E. Hoxhës.

Në përputhje me konsideratën e përgjithshme që ata dora-dorës duhej të punonin për dobësimin dhe përmbysjen e regjimit komunist, përveç veprimeve politike e diplomatike, SHBA dhe Britania e Madhe gjatë viteve 1949-1953, organizuan aksionin e parë dhe të vetëm diversiv antikomunist në Evropë, i cili u drejtua pikërisht kundër qeverisë së Shqipërisë. Përkrahja që qeveria shqiptare u kishte dhënë gueriljeve greke ishte njëra nga arsytet që i shtyu Aleatët Perëndimorë në ndërmarrjen e këtij aksioni.

Shfatat e Shtabit të Ushtrisë Amerikane e parashikonin pushtimin e Shqipërisë vetëm në rastin e shpërthimit të luftës nga blloku sovjetik kundër Greqisë dhe Jugosllavisë, duke gjykuar se nga pikëpamja ushtarake, ishte e padëshirueshme që Jugosllavia të lejonte Shqipërinë e lidhur me Kremlinin të qëndronte pa përkujdesje në krahun e saj. Pikërisht për këto arsye Fuqitë e NATO-s u përpoqën të kordinonin politikatat e tyre për të arritur një mirekuptim për vijën e ndarjes së Shqipërisë. Kriteret për përcaktimin e saj ishin politike

dhe ushtarake. Më e parapëlqyeshme ishte vija e lumit Shkumbin, sepse kështu pushtimit grek nuk do t'i jepej ngjyra e një zotërimi të përhershëm, por ai do të kishte trajtën e një pushtimi të përkohshëm

Zgjerimi i prezencës së NATO-s në Greqi shkaktoi një tension të ri midis qeverisë shqiptare dhe asaj greke. Kështu ndodhi edhe në rastin e marrëveshjes greko-amerikane për bazat ushtarake që u shpall më 12 tetor të vitit 1953. Qeveria shqiptare i drejtoi një protestë qeverisë greke nëpërmjet OKB. Ajo e quante krejt të pamotivuar vendosjen e bazave amerikane dhe deklaroi se Greqia nuk kërcënohej nga ndonjë rrezik. Këtë ia përsëriti Greqisë edhe qeveria sovjetike. Tirana deklaroi se e quante vendosjen e bazave të NATO-s në tokën greke si një kërcënim të drejtpërdrejtë për paqen dhe sigurimin në Ballkan, si një akt që po u shërbente planeve për shpërthimin e një lufte të re. Ajo akuzonte Greqinë se kishte vënë tokën e saj në shërbim të planeve të shteteve të tjera, duke keqësuar kështu gjendjen ndërkombëtare “në një kohë kur të gjitha shtetet paqedashëse po punonin për uljen e tensionit”. Përgjegjësia e qeverisë greke për keqësimin e gjendjes ndërkombëtare u theksua edhe në propagandën shqiptare.

Si anëtare e dyfishtë e NATO-s dhe e Paktit Ballkanik, Turqia mbante qëndrim dhe kishte synime afatgjata pozitive ndaj Shqipërisë. Ajo ishte kundërshtar e pretendimeve tokësore greke në kurriz të Shqipërisë, mbështeste integritetin e saj territorial dhe përpiqej për ta tërhequr shtetin shqiptar në anën e Perëndimit dhe në Paktin Ballkanik.

Një qëndrim më të hapur dhe të afishuar dukshëm në favor të mbrojtjes së pavarësisë dhe tërësisë tokësore të Shqipërisë mbajti Italia fqinje. Në vitin 1957 MPJ e Italisë i tërhoqi vëmendjen palës shqiptare për rrezikun e politikës greke. Orlando i tha në mënyrë konfidenciale ambasadorit shqiptar se tani problemi i Qipros po hynte në rrugën e zgjidhjes dhe se “di me siguri që me të përfunduar çështja e Qipros, Greqia do të aktivizohet në drejtim të Shqipërisë së Jugut”. Ai premtoi se “Italia do të bënte roje kundrejt aventurave eventuale greke” dhe këshilloi palën shqiptare se “në radhë të parë ju takon juve të jeni në roje, pasi nga grekët mund të pritët çdo gjë”. Interessant ishte fakti se, Orlando e la shtegun të hapur ndaj rektifikimeve kufitare që mund të pranoheshin nga të dyja palët. Ai tha se kjo ishte tjetër gjë dhe “nuk na intereson, sepse kjo është çështja juaj e brendshme. Por ne nuk duam të merren veprime të njëanshme nga Greqia”. Orlando deklaroi se këto pikëpamje Italia ua kishte bërë të qarta edhe aleatëve të saj të NATO-s. Diplomatët shqiptarë në Romë e komentuan këtë qëndrim të Italisë si një shqetësim të saj, se në procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Greqinë, Shqipëria, e shtyrë edhe nga B. Sovjetik, mund t'i bënte koncensione Greqisë. Pra ata mendonin se “Italia po përpiqej t'i vinte në roje karshi një situatë të tillë” dhe i vlerësonin si të drejta konsideratat italiane për politikën greke. Legata shqiptare në Romë i shkruante MPJ se Italia, për

qëllimet e saj të njohura, nuk do ta shihte me sy të mirë zgjerimin e Greqisë në kurriz të Shqipërisë”.

Në vitin 1959 Ambasada shqiptare në Paris i propozoi ambasadës turke atje vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Turqinë. Propozimi i palës shqiptare u prit mirë nga Ankaraja, e cila informoi NATO-n se ajo dëshironte të vendoste marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë. Amerikanët nuk e kundërshtuan këtë hap. Vetëm se ambasada amerikane në Athinë ishte e shqetësuar, ngaqë grekët ishin shumë të ndjeshëm ndaj kësaj çështjeje dhe për shkak të situatës politike në Greqi gjatë periudhës zgjedhore. Kështu që ajo i sugjeroi Departamentit të Shtetit se, do të ishte shumë e dëshirueshme që përfaqësuesi grek në NATO të kishte mundësinë të komentonte rreth veprimit që parashikonte të ndërmerre qeveria turke. Gjithashtu ajo shpresonte që turqit do të konsultoheshin me NATO-n përpara se të bisedonin me shqiptarët.

Qeveria turke, jo vetëm që ishte e vendosur t'i përmirësonte marrëdhëniet, por, me sa duket, donte të ndikonte që edhe grekët të bënin ndonjë lëvizje pozitive në këtë drejtim. Gazeta turke “Hurriyet” më 20 maj, pasi njoftonte vendosjen e marrëdhënieve turko-shqiptare, theksonte se tashmë pritej që edhe Greqia, SHBA dhe Britania e Madhe të vepronin në këtë mënyrë brenda një kohe të shkurtër.

Në mesin e vitit 1958 vendosja e bazave amerikane të raketave në Itali, shembull të cilin dukej qartë se do ta pasonte dhe Greqia, e rriti përsëri tensionin dhe pakënaqësinë midis shqiptarëve dhe grekëve. Shtypi grek filloi të alarmonte opinionin vendas për vendosjen e bazave të raketave bërthamore ruse në Bullgari dhe në Shqipëri. Qeveria sovjetike i kërkoi qeverisë shqiptare dhe asaj bullgare që të bënin një deklaratë ku të paralajmërohej Italia, por indirekt edhe Greqia e Jugosllavia, mbi pasojat që mund të kishte vendosja e bazave të raketave amerikane në këto vende. Shqipëria duhej të deklaronte se, si anëtare e Traktatit të Varshavës, do të merrte masa të njejta për mbrojtjen e saj. MPJ e B.Sovjetik informoi ambasadën shqiptare në Moskë, se pasi bazat amerikane do të vendoseshin në Itali, B.Sovjetik do t'ia bënte këtë propozim Shqipërisë.

Natyra stabilizuese e politikës së vendeve udhëheqëse të NATO-s në Ballkan dhe përkrahja e vendosur e integritetit territorial dhe pavarësisë së Shqipërisë ishin evidente qysh në këtë kohë të vështirë të konfrontimit Lindje-Perëndim. Kjo politikë ishte përcaktuese edhe në drejtim të politikave ekspansioniste të fqinjëve ballkanik kundrejt Shqipërisë, duke i frenuar dhe moderuar ato. Iniciativat paqësore amerikane në Ballkan, veçanërisht vendosja e marrëdhënieve me Bullgarinë dhe deklarata e Departamentit të Shtetit më 28 nëntor 1959, e cila i referohej “simpatisë dhe mirëkuptimit” amerikan ndaj dëshirave të popullit shqiptar, e nxiti diplomatin e njohur grek P.Pipinelis që të parashtronte edhe një here pikëpamjet e tij për situatën e re që ishte krijuar. Në një artikull të botuar në gazetën “Kathimerini”, më 6 dhjetor 1959, ai shkruante

që, SHBA u duhej kujtuar se Greqia kishte dhjetë vjet që po priste shqyrtimin e kërkesës së saj për “Epirin e Veriut

Kështu nacionalizmi ekstrem e bënte Pipinelisin të shkruante se, “kur aleati ynë transatlantik përmend “mirëkuptimin për dëshirat e popullit shqiptar, ne na hapet një plagë e vjetër dhe shumë e dhimbshme”. Ai shprehte dëshpërimin dhe frikën se, “në qoftë se fryma e ç`tensionimit vazhdonte, Greqia shumë shpejt do të ndodhej në një pozitë ku do të akuzohej si turbulluese e frymës së ripajtitimit prej këmbënguljes në kërkesën për Epirin e Veriut”. Ajo “po përballej me dilemën që, ose do të kundërshtonte përpjekjet për bashkekzistencën paqësore me fqinjët e saj, ose do të përfshihej në bisedime, rezultati negativ i të cilave ishte i sigurt, ndërsa shfrytëzimi i tyre në dëm të saj, ishte edhe më i sigurt”. Mirëpo vendet udhëheqëse të NATO-s vijuan rrugën e dekurajimit të nacionalizmit grek.

Problemi i çarmatimit atomik dhe ai i vendosjes së raketave amerikane në Greqi, jo vetëm që e rënduan më tej atmosferën, por për herë të parë lëkundën seriozisht besimin e udhëheqjes shqiptare tek mbrojtja dhe përkrahja sovjetike dhe i rriten dilemat e sigurisë së saj. Më 30 maj 1959, qeveria shqiptare dhe qeveria sovjetike bënë një deklaratë të përbashkët për shndërrimin e Ballkanit dhe zonës së Adriatikut në një zonë paqeje, pa baza, armë atomike dhe raketa.

Udhëheqësit e të dy vendeve deklaruan botërisht se, në qoftë se Greqia do të pranonte vendosjen e bazave amerikane për armë dhe raketa atomike, qeveritë e RPSH dhe të BS do të merreshin vesh midis tyre për të vendosur në territorin shqiptar baza për lëshimin e raketave të drejtuara kundër Italisë dhe Greqisë. Por në tekstin përfundimtar të deklaratës së përbashkët u hoq përcaktimi që ato do të drejtoheshin kundrejt Italisë e Greqisë, i cili kishte qenë në projektin e saj.

Amerikanët ishin të shqetësuar nga këto lëvizje të Hrushovit. CIA relatonte se, kërcënimi i Hrushovit për vendosjen e bazave të raketave në Shqipëri dhe thirrja për një konferencë ballkanike që do të diskutonte krijimin e një zone të ç`atomizuar në Ballkan dhe në pellgun e Adriatikut, mund të kishte për qëllim që të rriste presionin ndaj qeverive greke e italiane, të krijonte një përçarje të NATO-s dhe, ndofta, edhe për të gjetur pretekstin që të vendoste bazat e raketave në Shqipëri.

Duke injoruar presionet, deklaratat dhe paralajmërimet e qeverisë shqiptare dhe të bllokut sovjetik në përgjithësi, Greqia vazhdoi rrugën e saj të bashkëpunimit me NATO-n dhe shpejt u njoftua se në Greqi do të vendosej kontigjenti i parë i raketave amerikane. Qeveria shqiptare ishte e alarmuar. Nesti Nase u takua në Moskë me Firjubin, i cili i tha se qeveria sovjetike nuk kishte marrë akoma qëndrim dhe se po priste të dhëna konkrete mbi qëndrimin e qeverisë greke. Udhëheqja shqiptare filloi të ndjehej e tradhtuar, duke parë se qeveria sovjetike po i shmangej angazhimit të saj dhe premtimit që kishte bërë Hrushovi gjatë vizitës në Shqipëri, për vendosjen e bazave të raketave

bërthamore sovjetike në Shqipëri, në qoftë se baza të tilla amerikane vendoseshin në Greqi. Kjo politikë e vendosur e NATO-s nuk mund të ketë kaluar pa pasoja mbi politikën e E Hoxhës i cili e pa qartë se çfar vendi zinte në projektet sovjetike dhe në raportet midis NATO-s dhe Traktatit të Varshavës. Kjo situatë me siguri ka qenë një ndër faktorët që e bënë qeverinë komuniste shqiptare të rishqyrtonte dhe rivlerësonte edhe një herë pozitën e saj ndërkombëtare dhe politikën e saj të jashtme.

Në këto momente të vështira, kur udhëheqja shqiptare po ndiente se gurët po i lëviznin nën këmbë, asaj i erdhën dy sinjale shpresëdhënëse. Shpresa vinte pikërisht nga ato shtete antare të NATO-s që kishin pasur një qëndrim pozitiv tradicional kundrejt pavarësisë dhe tërësisë toksore të Shqipërisë. Sinjali i parë erdhi nga Roma. Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Italiane i dërgoi një raport Komandës së NATO-s, i cili nënvizonte se Çamëria ishte një krahinë shqiptare, kritikonte qëndrimin negativ të qeverisë greke në disa çështje ballkanike, veçanërisht pretendimin mbi gjendjen e luftës midis Greqisë dhe Shqipërisë dhe pretendimin për “Epirin e Veriut”. Kjo mjaftoi për të krijuar një tension midis Greqisë dhe Italisë edhe pse ata ishin dy shtete aleate antarë të NATO-s.

Qeveria greke reagoi ashpër kundrejt këtyre materialeve dhe apeloj në Shtabin e NATO-s. Në Greqi shpërtheu një histeri e re nacionaliste. Ministri i Jashtëm grek Averoffi, thirri më 11 maj 1960 ambasadorin italian, të cilit i bëri një protestë të ashpër. Këtë protestë të nesërmen e shoqëroi me një notë zyrtare me shkrim. Në notën greke pretendohet se dokumenti italian ishte përdorur nga forcat e armatosura italiane për indoktrinimin e trupave. Averoffi i kërkoi ambasadorit italian, Conti që qeveria italiane të bënte një deklaratë publike, në të cilën të thuhet se ky raport ishte paraqitur nga një “idiot” ose “fashist”. Shtypi grek reagoi, duke bërë një zhurmë të madhe me tone të larta shoviniste. Si pozita ashtu dhe opozita i cilësoi italianët si maskarenj. Ata deklaruan se në qeverinë italiane kishte akoma elementë fashistë dhe se, i gjithë incidenti ishte një akt mjerran i dështuar. Në notën e tij dorëzuar qeverisë italiane, ministri i Jashtëm grek përmendi edhe çështjen e “Epirit të Veriut”, gjë e cila u ngrit edhe në shtypin grek.

Qeveria greke informoi edhe amerikanët, të cilëve u bëri të ditur se, po të mos kishte një reagim të kënaqshëm nga italianët, do të shqyrtonte tërheqjen e ambasadorit të saj nga Roma “për konsultime të gjata”.

Italianët, të gjendur përballë këtij presioni, e tërhoqën zyrtarisht dhe publikisht dokumentin, shprehën keqardhjen e tyre dhe deklaruan se ai nuk reflektonte pikëpamjet e qeverisë italiane. Por Roma refuzoi të shkonte më tej, duke theksuar se ishte e papërshtatshme që t’i bënte një vërejtje të ashpër, publike Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Italiane, i cili ishte përgjegjës për hartimin e këtij dokumenti.

Edhe amerikanët u shqetësuan nga dokumenti italian, të cilin ata e vlerësuan si shumë të gabuar dhe fyes për grekët. Por ata po përpiqeshin të hetonin nëse qeveria italiane kishte pasur dijeni për dokumentin siç pretendonin grekët dhe, po të ishte kështu, përse ajo kishte lejuar që një dokument i tillë të përdorej për indoktrinimin e forcave të veta ushtarake? Cila agjensi ose çfarë interesash ishin ata që kishin çuar në paraqitjen e një panorame “kaq të shtrembër” të situatës shqiptare. Averoffi informoi ambasadorin amerikan në Athinë se, ai gojarisht, i kishte thënë ambasadorit italian që dokumenti ishte vepër e një dore komuniste, të cilën amerikanët, duke e krahasuar me informacionet që kishin, e quanin të mundshme. Por zyrtarisht grekët kishin akuzuar për këtë vepër elementët me mentalitet fashist që “ende ekzistonin në qeverinë italiane”. Prej disa zyrtarëve amerikanë edhe ky konsiderohej si një shpjegim i mundshëm, pasi kishte disa “shtrembërime” që reflektoheshin në disa pjesë të dokumentit, të cilat ata i konsideronin si “reminishencë e që reflektoheshin në disa pjesë të dokumentit, të cilat ata i konsideronin si “reminishencë e propagandës fashiste italiane lidhur me Shqipërinë”. Në mbështetje të këtij konkluzioni ata përmendnin edhe një material tjetër, i cili ishte përdorur nga një organizatë sekrete, ekstremiste e djathtë italiane me qëllimin kryesor që të mbante lidhje dhe të kontrollonte gjoja “ish-grupin profashist” Ballin Kombëtar. Po në mbështetje të kësaj teze, grekët informuan amerikanët se në Itali botohej një revistë, e cila ishte një zëdhënëse e IMRO-së, (grup nationalist maqedonas), që sulmonte në mënyrë sistematike Greqinë dhe Jugosllavinë, por jo Bullgarinë, lidhur me politikën maqedone të këtyre vendeve. Kështu që amerikanët dyshonin se edhe dokumenti i lartpërmendur mund të ishte vepër e elementëve të tillë.

Zyrtarët amerikanë gjithashtu parashikonin se, megjithëse mund të dukej jo logjike, ekzistonte mundësia që, për arsye të brendshme të Greqisë, çështja e “Epirit të Veriut” mund të aktivizohej brenda një kohe të shkurtër. Ata ishin të shqetësuar se strategjia sovjetike mund ta vlerësonte çështjen shqiptare dhe atë maqedone si një manovër të dobishme në betejën Lindje-Perëndim. Agjitacioni i suksesshëm për këtë çështje mund t’i fuste Greqinë, Italinë dhe Jugosllavinë në grindje me njëra-tjetrën, duke shkatërruar kështu njërin nga sukseset më të mëdha të diplomacisë perëndimore në periudhën e pasluftës.

Amerikanët mendonin se dukej qartë që në Greqi ekzistonin dyshime lidhur me një rigjallërim të aspiratave italiane në Ballkan të frymëzuara nga De Gaspari, të afta për të mbjellë një reaksion të fryrë, nëpërmjet ngritjes së një fantazme të vjetër, pavarësisht nëse dy parashikimet e paraqitura më lart reflektonin ose jo origjinën e këtij incidenti.

Duke e studiuar këtë incident, ata kishin arritur në dy përfundime kryesore: Së pari, se ekzistonin elementë realë të një rreziku në situatën e atëhershme, të cilët duheshin zbuluar; së dyti, kyçi i shpjegimit të kësaj situatë

mund të gjendej në origjinën e vërtetë të dokumentit, i cili e kishte krijuar këtë problem.

Ministria e Punëve të Brendshme e Shqipërisë gjykonte se kjo lëvizje e Romës ishte një kundërpërgjigje ndaj aktivitetit të ethshëm të Greqisë kundrejt Shqipërisë së Jugut. Gjithashtu, ajo e vlerësonte raportin e Shtatmadhorisë Italiane edhe si një shprehje “të qëllimeve imperialiste të Italisë”.

I gjithë ky incident provonte se çështja shqiptare ende e kishte potencialin të krijonte fërkime, tension edhe përçarje midis disa antarëve të NATO-s por provonte edhe faktin se megjithë natyrën krejtësisht të re dhe demokratike e progresive që kishte kjo aleancë, ajo nuk ishte krejtësisht e imunizuar ndaj ndikimit të faktorëve gërryes negative që e kishin origjinën qysh nga fillimet e shekullit të XX.

I njëjti përfundim mund të nxirrej edhe nga fërkimet greko-turke lidhur me çështjen shqiptare. Ministria e Punëve të Brendshme e Shqipërisë mendonte se, qeveria turke ishte përpjekur të mblidhte informacion për Shqipërinë, i cili i duhej asaj për të kundërshtuar pretendimet territoriale greke ndaj Shqipërisë, pasi ajo parashikonte që grekët mund t'i paraqisnin pretendimet e tyre në mbledhjen e ministrave të Jashtëm të vendeve të NATO-s që do të zhvillohej në Paris, më 13 dhjetor 1961. Autoritetet shqiptare e lidhnin shqetësimin e qeverisë turke me fushatën e pandërprerë që kishte zhvilluar qeveria greke për aneksimin e Shqipërisë së Jugut, sinjalet më të fundit të së cilës kishin qenë, letrat e Silogut “Vorio-Epirot” të Francës drejtuar ambasadës sovjetike në Paris, deklaratat e shumta të qeveritarëve grekë mbi “Vorio-Epirin”; dhe çka ishte më e rëndësishmja sondazhi që kishte bërë qeveria greke ndaj qeverisë austriake para mbledhjes së NATO-s më 13 dhjetor, mbi qëndrimin që do të mbante Vjena në rast se Greqia do të sulmonte ushtarakisht Shqipërinë. Ministria e Punëve të Brendshme gjykonte se, qeveria turke, për shkak të kontradiktave të vjetra me Greqinë, dhe për arsye se nuk kishte interesa të veçanta ndaj Shqipërisë, nuk i aprovonte planet greko-jugosllave kundër saj. Këtë konkluzion e kishte konfirmuar edhe qëndrimi i personaliteteve turke në një takim me diplomatët shqiptarë në Ankara. Kështu, Tirana besonte se qeveria turke mund të bënte përpjekje pranë aleatëve të saj për ndryshimin e qëndrimit të tyre ndaj Shqipërisë. Megjithëkëtë qeveria shqiptare deri në janar të vitit 1962, nuk kishte marrë të dhëna të konfirmuara nëse turqit i bënë këto përpjekje në mbledhjen e NATO-s.

Qëndrimet kontradiktore të qeverisë shqiptare ndaj Turqisë vazhduan edhe pas vitit 1962. Në vitin 1963 diplomacia shqiptare po merrte informacione dhe prova gjithnjë e më të qarta se, politika turke ndaj Shqipërisë kishte dhe një aspekt pozitiv dhe se ajo ishte orientuar vendosmërisht në mbrojtje të pavarësisë dhe integritetit të Shqipërisë. Legata e Shqipërisë në Ankara pohonte: “Sidoqoftë qëndrimi i vërtetë i Turqisë ndaj vendit tonë nuk është

dashakeqës”. Ajo njoftonte se ish ministri i Jashtëm turk, Fuat Koprulli, nënshkruer i Paktit Ballkanik, u kishte thënë diplomatëve shqiptarë se qeveria e tij “nuk pranoi asnjë klauzolë, qoftë edhe vetëm me nënkuptim, të propozuar nga grekët dhe jugosllavët me pikësynime kundër Shqipërisë”. Edhe ish-ministri i Jashtëm Fahti Rustu, i kishte informuar se Turqia ishte përkrahëse e Shqipërisë dhe se ajo i kishte pranuar kosovarët për humanizëm, por ishte gati të mos i pranonte në qoftë se këtë gjë e dëshironte Shqipëria. Qeveria shqiptare kishte dyshime lidhur me politikën dhe synimet e Turqisë ndaj emigracionit kosovar. Këto dyshime përforcoheshin nga informacionet që i vinin asaj se Turqia po u linte dorë të lirë jugosllavëve që të punonin me emigracionin kosovar, ndërsa kishte paralajmëruar legatën shqiptare që të mos bënte propagandë kundër Jugosllavisë në emigracionin shqiptar.

Udhëheqja shqiptare e shihte se guri themeltar, i palëvizshëm i politikës greke kundrejt Shqipërisë, ishte kërkesa nacionaliste greke për aneksimin e Shqipërisë së Jugut. Ajo gjykoj se në këto rrethana, Italia ishte më pak e rrezikshme, për arsye se ajo nuk kishte kufij tokësorë me Shqipërinë, ishte më popullore në Shqipëri dhe në të njëjtën kohë më e aftë për t’i dhënë Shqipërisë ndihmë ekonomike. Për më tepër, Italia gjithmonë kishte preferuar më mirë një Shqipëri të pavarur dhe të dobët, se sa një Shqipëri të ndarë ose të kontrolluar nga Jugosllavia dhe Greqia. Qeveria italiane ia kishte bërë të qartë palës shqiptare se asaj, jo vetëm nuk i interesonte cenimi i integritetit territorial të Shqipërisë, por edhe se nuk do ta lejonte një gjë të tillë. Ambasadori italian në Ankara, informoi diplomatët shqiptarë atje se “Italianët e kishin thënë troç që nuk do të lejonin asnjë prishje të statukuosë në Ballkan”, dhe se këtë gjë ua kishin thënë edhe grekëve në NATO. Më parë, edhe ambasada e Shqipërisë në Romë kishte informuar se, qeveria italiane do të kërkonte garanci në mbledhjen e NATO-s, e cila do të mbahej në dhjetor të vitit 1961 në Paris, që territori i Shqipërisë të mos kërcënohej nga Greqia dhe nga Jugosllavia. Rrjedhimisht, Tirana u orientua fillimisht drejt një afrimi të kufizuar e të matur me Romën.

Megjithatë duhet nënvizuar fakti se qeveria komuniste e Shqipërisë e konstatoi qartë politikën mbrojtëse të dy atarëve rajonalë të NATO-s por ajo nuk bëri asgjë që t’i përgjigjej në një mënyrë pozitive kësaj politike që ishte në favor të interesave shqiptare. Ajo vijoi kursin e saj të izolimit dhe stimulimit të propagandës dhe veprimtarisë armiqësore ndaj këtyre vendeve dhe Perëndimit në përgjithësi.

Situata e re që u krijua pas prishjes së marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike bëri që qeveria amerikane të vëzhgonte me imtësi zhvillimin e ngjarjeve dhe ta shtonte përqëndrimin e vëmendjes së saj në çështjen shqiptare. Një studim i plotë iu paraqit Presidentit nga Këshilli i Sigurimit Kombëtar në fillim të vitit 1962. Ai titullohej “Vendimet imediate të politikës amerikane lidhur me Shqipërinë”.

Ndër motivet që i nxitën amerikanët të rishikonin politikën e tyre ndaj Shqipërisë ishin: hetimet që kishin bërë dhe po bënin disa qeveri të vendeve të NATO-s lidhur me qëndrimin e SHBA kundrejt veprimeve të Shqipërisë dhe disa mendime për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike, rritjen e shkëmbimeve tregtare dhe dhënien e ndonjë ndihme të mundshme Shqipërisë në këto momente. Vështirësitë e shfaqura nga ana e Greqisë, Italisë dhe Jugosllavisë lidhur me zhvillimet që mund të ndodhnin si rezultat i situatës në Shqipëri dhe përgatitjet e heshtura që po bënte secila prej tyre për të mbrojtur interesat e veta atje. Këto përgatitje rrisnin mundësinë e aksioneve nga njëri apo tjetri shtet, gjë që mund të sillte pasoja serioze. Së fundi, problemi i trajtimit të konfliktit shqiptaro-sovjetik nga media në SHBA, veçanërisht çështja se çfarë përpjekjesh duheshin bërë për të shfrytëzuar këtë konflikt.

Hoxha dukej i vendosur të vazhdonte armiqësinë me sovjetikët dhe kjo grindje kishte origjinë dhe shkaqe të ndryshme nga ajo e kinezëve. Kështu që, ishte e dëshirueshme të krijoheshin lidhje të reja midis Shqipërisë e Perëndimit, të mjaftueshme që t'i hapnin regjimit të Tiranës një rrugë të tretë për të mbijetuar. Këto lidhje duhej të përfshinin, jo vetëm marrëdhëniet e reja tregtare që po përpiqej të krijonte Shqipëria por, gradualisht, të zgjerohej edhe njohja diplomatike e saj.

SHBA e gjykonin të nevojshme, gjithashtu, të pakësonin rreziqet që vinin nga fqinjët e Shqipërisë, të cilët mund të prishnin planet shqiptare. Athina, Roma dhe Beogradi pretendonin se kishin interesa të rëndësishme në Shqipëri. Asnjëri prej tyre nuk kishte shfaqur ndonjë synim për ta shfrytëzuar situatën e krijuar në kurriz të Shqipërisë. Por në rastin e ndonjë zhvillimi tjetër, i cili do të dukej se do të krijonte një rast të favorshëm, njëri ose tjetri mund të ndërmerre ndonjë iniciativë turbulluese. Kishte më shumë të ngjarë që njëri prej të tre fqinjëve, në mënyrë të dukshme ose të padukshme, i alarmuar nga synimet e të tjerëve, mund të lëvizte për të mbrojtur interesat e tij. Në rrethana të tilla një qëndrim tërësisht pasiv i SHBA kundrejt Shqipërisë, mund t'i inkurajonte këto tendenca destabilizuese në politikën e fqinjëve të Shqipërisë dhe do të ndillte zhvillimet e një karakteri, që politika amerikane, më së shumti, donte t'i shmangte. Departamenti i Shtetit dëshironte një politikë të "duarve- larg" nga Shqipëria nga ana e fqinjëve të saj, e cila në të njëjtën kohë të siguronte që shpërthimi i kazanit në Tiranë nuk do ta çonte Shqipërinë në grykën e njërit apo tjetrit fqinj. Kursi më i mirë për amerikanët ishte ai që krijonte siguri kundrejt të gjitha rreziqeve që u përmendën më lart, por pa u përzier ShBA, hapur dhe drejtpërdrejt, me regjimin e atëhershëm të Shqipërisë SHBA, të lejonin pa zhurmë shkëmbimin e mallrave me Shqipërinë në të njëjtat kushte, siç ishte lejuar shkëmbimi me satelitët e tjerë evropianë-lindorë, të favorizonin zgjerimin e tregtisë midis vendeve të NATO-s dhe Shqipërisë në qoftë se autoritetet shqiptare do të përpiqeshin për këtë, por në këtë moment kjo do të bëhej thjesht

mbi baza komerciale – domethënë të mos jepeshin kredi përtej nivelit të kredive normale tregtare. Për këtë qëllim, kjo politikë do të koordinohet në Këshillin e NATO-s.

SHBA do të favorizonin zgjerimin e marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe shteteve jokomuniste, por me një ritëm dhe në kushte, të cilat nuk do të tregonin se ekzistonte një plan ose përpjekje e organizuar perëndimore për të fituar Shqipërinë. Për këtë qëllim SHBA, do të përpiqeshin që të miratonin një politikë të koordinuar për njohjen e Shqipërisë në Këshillin Konsultativ të NATO-s. SHBA duhet të ishin të përgatitura për të shqyrtuar, në një moment urgjent, masat që do të bënin të mundur marrjen e furnizimeve të nevojshme nga Shqipëria nëpërmjet një pale të tretë dhe të përshtatshme por jo drejtpërdrejtë nga SHBA, për të mbijetuar në qoftë se Pekini nuk do t'i jepte mbështetjen e nevojshme dhe në qoftë se një krizë serioze do të kërcënonte Shqipërinë. SHBA do të vazhdonin konsultimet me qeveritë greke, italiane e jugosllave në lidhje me situatën në Shqipëri dhe t'u bënin atyre të qartë se, amerikanët do ta shihnin me shqetësim dhe se, e vlerësonin si të dëmshme e të papranueshme ndonjë përpjekje të kujt do prej tyre që të braktiste politikën e “duarve-larg” nga Shqipëria. Në fakt kjo politikë e SHBA u bë vija kryesore udhëheqëse e qëndrimeve të NATO-s kundrejt Shqipërisë. Ajo i shërbeu si ruajtjes së stabilitetit në Ballkan, ruajtjes së paprekur të avantazheve që kishte krijuar NATO pas shpërthimit të konfliktit sovjet-shqiptar dhe mbi të gjitha ruajtjes së patrazuar të kohezionit dhe marrëdhënieve të qeta midis antarëve rajonal të NATO-s që ishin fqinjë të Shqipërisë.

Pas agresionit të B.Sovjetik kundër Çekosllovakisë, në gusht të vitit 1968 dhe me shpalljen e doktrinës së Brezhnjevut mbi sovranitetin e kufizuar, u përforcua frika e qeverisë së Tiranës nga rreziku i ndonjë agresioni iminent sovjetik. Shqipëria kishte vite që po e ndjente izolimin. Ajo kishte dhënë shenja se e dëshironte detantën me fqinjët e saj armiqësor, por tani kjo nevojë për përmirësimin e marrëdhënieve u bë edhe më e domosdoshme, më kritike dhe më urgjente. E.Hoxha e kuptoi se, NATO, duke mbështetur Jugosllavinë, tërthorazi do të mbështeste edhe sigurimin e Shqipërisë. Pikërisht për këtë arsye, u rigjallëruan disi shpresat për përmirësimin e marrëdhënieve me Greqinë

Pas agresionit sovjetik kundër Çekosllovakisë kujdesi i SHBA ishte fokusuar në Ballkan, si një zonë tjetër ku sovjetikët mund të ndërhyjnë ushtarakisht KONSIDERATA thelbësore e NATO-s ishte se, forcimi i influencës sovjetike në Ballkan do të kishte ndikim të dukshëm në balancën e forcave në të gjithë Mesdheun Lindor. Potencialisht ajo mund të kishte efekte destabilizuese në Greqi, në Turqi dhe në Itali. Kështu që, politika bazë e saj e cila buronte nga këto konsiderata, ishte mbështetja e vendeve ballkanike që të ruanin pavarësinë e tyre nga Moska.

Pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë qeveria greke u përpoq të merrte rolin e ndërmjetësit për hapjen dhe afrimin e Shqipërisë drejt NATO-s dhe SHBA. Në fakt, amerikanët konstatonin se, grekët po përpqeshin të paraqiteshin si zëdhënës të tyre në Shqipëri dhe ishin të shqetësuar për këtë gjë. Po të njejtin shqetësim atyre ua kishin shprehur edhe jugosllavët. Zyrtarë të ambasadës jugosllave në Athinë u thanë diplomatëve amerikanë se, diplomacia greke, në mënyrë të vazhdueshme, po përpqej të paraqitej tek qeveritë jugosllave e shqiptare si kanali më i mirë drejt SHBA, NATO-s dhe Perëndimit në përgjithësi.

Departamenti i Shtetit donte t'i dekurajonte spekulimet rreth rolit ndërmjetësues të Greqisë apo të një pale tjetër në këtë proces, sepse dukej qartë që, qeveria greke po përpqej ta mbante të gjallë këtë ide.

Si përfundim mund të nxjerrim disa konkluzione lidhur me raportet e NATO-s dhe vendeve anëtare të saj me Shqipërinë:

Së pari, gjatë gjithë periudhës së Luftës së Ftohtë NATO, pavarësisht nga konsideratat se Shqipëria ishte një vend satelit i bllokut komunist dhe, si e tillë, përbënte një rrezik për paqen dhe lirinë, asnjëherë nuk u lëkund nga parimi i respektimit të pavarësisë së Shqipërisë.

Së dyti, edhe pse ndonjëri prej vendeve anëtare të NATO-s kishte pretendime territoriale që cenonin pavarësinë dhe integritetin e Shqipërisë, Aleanca shërbeu si organizëm amortizues që i fashiti dhe i frenoi këto aspirata dhe objektiva.

Së treti, respektimi i pavarësisë së Shqipërisë dhe i integritetit të saj territorial u vlerësua nga NATO, jo vetëm si një politikë që do t'i jepte mundësi popullit shqiptar që në të ardhmen të demonstronte orientimin e tij properëndimor, por edhe si një kusht dhe faktor i rëndësishëm për të ruajtur kohezionin në radhët e Aleances si dhe stabilitetin në krahun Juglindor të saj.

Së katërti, Aleatët e NATO-s përcaktuan si objektiv themelor që të punonin dora-dorës për përmbysjen e regjimit komunist të Shqipërisë, pa krijuar trazira në Ballkan dhe që në të ardhmen të krijohej një qeveri demokratike properëndimore e lirë nga influencat dominuese të huaja.

#### **Bibliografia:**

*Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Shqipërisë (AMPB)*

*Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë (AMPJ)*

*Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)*

Public Records of Foreign Office, London (FO)

*United States National Archives (USNA)*

BIBERAJ, Elez – *Albania and China - A study of on unequal Alliance*, Boulder and London, "Westview Press", 1986.

- COUFOUDAKIS, Van – “The Reverse Influence Phenomenon: The Impact of the Greek-American Lobby”, on the Foreign Policy of Greece”, në botimin e Dimitri Konstas dhe Athanassios G.Plattas me titull: *Diasporas in World Politics – The Greeks in Comparative Perspective*, London 1993.
- GOLDBLOOM, Maurice – “United States Policy in Post War Greece”, në botimin e Richard Clogg dhe të George Yannopoulos: *Greece Under the Military Rule*, New York.
- JELAVICH, Barbara – *History of the Balkans, Twentieth Century*, volume 2, Cambridge: “Cambridge University Press”, 1983.
- KOFOS, Evangelos – “Greece and the Balkans, 1974-1986” në botimin e Speros Vryonis, Jr. me titull: *Greece on the Road to Democracy: From the Junta to PASOK, 1974-1986*.
- STAVROU, Nicolaos – “Greek-American Relations and Their Impact on Balkan Cooperation”, në botimin e Theodore Coulombis dhe të John Iatrides me titull: *Greek-American Relations: A Critical Review*, New York: 1980.
- STEFANIDIS, Joannis – “United States, Great Britain and the Greek – Yugoslav Rapprochement, 1949-1950”, në *Balkan Studies*, vol.27, nr.2, Thessaloniki: 1986.
- VALINAKIS, Giannis – *Balkan Security: Recent Developments and Prospects for the Future* (mimeographed 1986).
- Albanian Catholic Bulletin*, New York
- Bashkimi*, Tiranë
- Dielli*, Boston, New York
- Flamuri*, New York
- Shqipëria*, New York
- Zëri i Popullit*, Tiranë

